



Dita Ndërkombëtare e Aksesit Universal në Informacion (IDUAI)

28 shtator 2020 – Sot ne celebroidim Ditën Ndërkombëtare të Aksesit Universal në Informacion (IDUAI).

Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC) ka kënaqësinë të punojë me UNESCO-n dhe organizatat e tjera partnere, përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile, për të celebruar këtë ditë të rëndësishme për promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtës Universale për Akses në Informacion.

Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe kolegët tanë janë bashkuar gjatë kësaj pandemie për të ritheksuar rëndësinë që kanë ligjet e të drejtës për informim në forcimin e besimit të publikut tek shteti. Hapja dhe transparenca, ashtu si edhe publikimi në mënyrë proaktive i informacionit, janë kushti thelbësor që i mundëson qytetarëve të kuptojnë më mirë vendimmarrjen.

Komisionerët e Informimit luajnë rol kyç në vënien e autoriteteve publike para përgjegjësisë, që këto të fundit të garantojnë regjistrimin dhe menaxhimin në mënyrën e duhur të informacionit, përpunimin e saktë të tij dhe respektimin e aksesit në informacion, publikimin në mënyrë proaktive dhe detyrimet e tjera ligjore, sidomos në një situatë emergjence publike.

Në këtë kontest, Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC) ripërsërit komunikatën e saj të muajit prill 2020, në të cilën mbështetet një pozicion fleksibël për sa i takon interesit shtrëngues publik në lidhje me emergjencën e aktuale shëndetësore, duke mbrojtur njëkohësisht vlerat e së drejtës për t'u informuar.

Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit është rritur gjatë vitit 2020, si për sa i takon anëtarësisë, ashtu edhe angazhimit të saj të shtuar në raport me vizionin dhe vlerat e Statutit të ICIC-së¹. Kjo rritje e vëmendjes vërteton rëndësinë e aksesit universal në informacion dhe domosdoshmërinë për të forcuar Komisionerët e Informacionit, shoqërinë

¹ Statuti i Johannesburgut u miratua më 13 mars 2019 me anë të një rezolute të Komisionerëve të Informimit të pranishëm në mbledhjen me dyer të mbyllura gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, në Johannesburg, Afrika e Jugut. Më tepër informacion i disponueshëm në lidhjen <https://www.informationcommissioners.org/the-icic-johannesburg-charter> (shën. për.).

civile dhe organizatat ndërkombëtare që të punojnë së bashku për të përmirësuar standardet.

Ndërsa të gjithë aktorët e angazhuar në promovimin dhe mbrojtjen e së drejtës për t'u informuar nisin të celeburojnë Ditën Ndërkombëtare të Aksesit Universal në Informacion 2020, Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit ka kënaqësinë të njoftojë nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me UNESCO-n, i cili do të na ndihmojë të shkëmbejmë ekspertizë për krijimin e mjeteve dhe mënyrave konkrete për arritjen e praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare në kontekstin e aksesit në informacion.

Fund